



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA**

SCL-11-0049

27 shtator 2019

Ankuesi

K Sh.A. – Prishtinë.

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 27 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. APROVOHET ankesa si e bazuar dhe ANULOHET vendimi i AKP-së – Autoritetit të Likuidimit GJI072-0040, i datës 03 qershor 2011.**
- 2. DETYROHET AKP - Autoriteti i Likuidimit të NSH-së në likuidim, që në emër të borxhit, ti paguaj K-ut, shumën prej 861.92 euro, shumë e cila do të paguhet në procedurën e likuidimit dhe përmbushjes së kërkesave, sipas prioriteteve dhe interesave.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 02 dhjetor 2011, ankuesi, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë/kërkesë, kundër Vendimit nr. GJI072-0040, të datës 03 qershor 2011, të Komisionit të Likuidimit, (tani Autoriteti i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar pagesën për furnizimin e pa paguar të energjisë elektrike në shumë prej 861.92 € për NSH-së në likuidim, në Ferizaj.

Ankuesi ka pohuar se NSH-së, Ferizaj energjinë elektrike e ka shfrytëzuar në disa pika matëse gjegjësisht njehsor dhe se K-u pas luftës është përballur me shumë vështirësi duke përfshi edhe mungesën e dokumentacionit. Po ashtu, ankuesi ka pohuar se në kohën kur është shpallur likuidimi i NSH-së, e ka parashtruar kërkesën për borxh në afatin ligjor dhe se në kërkesën bazë nuk është përfshirë borxhi i rrymës për shifrën DFE 9002371 në lartësi prej 861.92 € dhe se kjo është një kërkesë plotësuese dhe vazhduese e kërkesave të mëhershme. Ankuesi ka pohuar se për shkak të rrethanave të paraqitura pas luftime, mungesa e dokumentacionit, mungesa e bashkëpunimit në mes palëve, janë arsye të cilat nuk e kanë paraqitur këtë kërkesë në kohën e ushtrimit të kërkesës bazë dhe se këto arsye të cilat i kanë parashtruar edhe tek KL-ja. Në mbështetje të ankesës, ka dorëzuar dokumentet në kopje si në vijim: vendimin e kundërshtuar, korrigjimin e kërkesës për borxh, e datës 06 mars 2007, njoftimet e datës 04 tetor 2011 nr. 30 dhe 20, lidhur me ankesat e parashtruara nga K-u.

Me 08 shkurt 2017, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se i qëndron plotësisht argumenteve të vendimeve të Komisionit të Likuidimit duke shtuar se e kundërshton si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar. Po ashtu, e paditura ka pohuar se justifikimi i parashtruar nga ankuesi lidhur me vështirësitë e gjetjes së dokumentacionit është një justifikim subjektiv dhe si i tillë nuk mund të pranohet si i vlefshëm, ankuesi nuk kishte asnjë pengesë që ta gjente dokumentacionin në kohën e duhur. E paditura ka pohuar se sa i përket pretendimit se kërkesa në shqyrtim ishte vetëm korrigjim i një kërkesë të dorëzuar më parë është i pa bazuar në ligje dhe prova. Andaj propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 13 shkurt 2017, mbrojtja e të paditurës i është dërguar ankuesit dhe ndaj të njëjtës nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e ankuesit aprovohet si bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi dorëzoi kërkesën në Komisionin e Likuidimit brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKM-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. Sipas provave që gjenden në shkresat e lëndës, ndërmarrja NSH , kishte hyr në proces të likuidimit nga data 25 korrik 2006. AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë

kreditorët potencial të NSH-së (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave ishte deri me datën 25 shtator 2006. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor me datat 20 korrik 2006 dhe në web sitin e AKM-së.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën (plotësimin e saj) i'a kishte parashtruar Komisionit të Likuidimit me 06 mars 2007. Gjykata gjen se KL vendosi rreth kërkesës në fjalë vetëm më 3 qershor 2011, ku refuzoi kërkesën e ankuesit si të papranueshme pasi ajo ishte dorëzuar jashtë afatit të paraparë e që data e fundit për dorëzimin e kërkesave ishte 25 shtator 2006.

Gjykata konsideron se KL gabimisht refuzoj kërkesën (plotësimin) e ankuesit, kjo pasi plotësimi i ankesës u bë ende pa u vendosur rreth kërkesës kreditore të tij. Në shumicën e procedurave përfshirë edhe procedurat administrative kërkesa mund të ndryshohet apo plotësohet deri në përfundim të saj, andaj KL pa të drejtë refuzoi kërkesën (plotësimin e saj) si të pasafatshme.

Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (ligj i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së vendimit nga KL), në nenin 24 përcakton themelimin dhe përbërjen e Komisioneve shqyrtuese, derisa neni 24.5 parasheh që:

Komisioni Shqyrtues duhet të marrë parasysh të gjitha provat dhe shkresat ekzistuese si dhe provat dhe shkresat e paraqitura më vonë nga pala e dëmtuar nga vendimi ose veprimi i Agjencisë ose komisionit të likuidimit.

Për shkak të ndryshimeve ligjore përkatësisht shfuqizimit të këtij ligji përmes hyrjes në fuqi të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (ligj në fuqi prej 21 shtator 2011), pra gjatë kohës sa zhvillohej kjo procedurë, neni 24.5 mbeti i pazbatueshëm rrjedhimisht plotësimi i ankesës u refuzua si i pasafatshëm, gjë që ankuesit i pamundësoi shfrytëzimin e të drejtës së tij për plotësim të kërkesës, gjersa procedura ishte në zhvillim e sipër.

Nisur nga kjo situatë, gjykata e gjen të zbatueshëm nenin 50.1 të Ligjit nr. 02/L-28, për Procedurën Administrative, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 8, datë 1 janar 2007, ligj i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së vendimit nga KL, i cili parasheh:

Pas fillimit të procedimit administrativ dhe deri në nxjerrjen e aktit përkatës administrativ, personat e interesuar mund të plotësojnë ose ndryshojnë kërkesën e tyre fillestare, edhe në qoftë se një modifikim i tillë bëhet shkas për ndryshimin e bazës ligjore, në bazë të së cilës shqyrtohet kërkesa, me kusht që kërkesa e plotësuar të bazohet në të njëjtat fakte si dhe kërkesa e parë.

Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata gjen se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe aprovon atë në lartësinë e shumës së kërkuar në procedurën e likuidimit tek KL-ja, pra në shumë prej 861.92 €, shumë që gjegjësisht ishte refuzuar me vendimin nr. lënde GJI072-0040, datë 03 qershor 2011. Kontestimi i lartësisë së detyrimit nga e paditura nuk është i mbështetur në prova, andaj gjykata aprovoi detyrimin në lartësinë e kërkuar.

Në lidhje me arsyetimin e ankuesit për plotësimin e ankesës, (i cili plotësim nga e paditura u shqyrtua si kërkesë e veçantë dhe u refuzua si e dorëzuar jashtë afatit), se deri tek kjo situatë ankuesi erdhi për shkak të "rrethanave të paraqitura pas lufte, mungesa e dokumentacionit,

mungesa e bashkëpunimit në mes palëve, etj” gjykata konstaton se përgjithësimet e tilla nuk mund të justifikojnë lëshimet e ankuesit për identifikimin, menaxhimin apo kontrollet e orë-matësve të energjisë elektrike, mirëpo çështje të tilla nuk janë në shqyrtim në këtë procedurë, prandaj gjykata shqyrtoi kërkesën e ankuesit dhe e pranoi si të bazuar vetëm brenda të drejtës për ndryshim dhe plotësim të kërkesës përderisa procedura ishte në zhvillim e sipër.

Nga kjo që u theksua më lartë dhe në kuptim të dispozitave të neneve 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi, tanimë ka bërë pagesën e taksës gjyqësore, ne shumë prej 15.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
gjyqtar

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Aktgjykimi duhet t’i dorëzohet palëve.